




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

**RREGULLORE (KGJ) NR. 2/2023 PËR PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË
TEATRIT TË QYTETIT GJILAN**

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të ligjit për Teatrot, nr.04/L-106
Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur më 04.08.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE (KGJ) NR.02/2023 PËR PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT TË
QYTETIT GJILAN**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë, procedurat e punës, thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit si dhe çështjet e tjera të punës së Këshillit Krejtues të Teatrit të Qytetit Gjiçan.

Neni 2

Funksionimi i këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues është organ kolektiv drejtues, i cili aprovon politikat e përgjithshme të Teatrit të Gjiçanit, sipas ligjit NR.04-106 për Teatrot dhe Statutit të Teatrit të Qytetit Gjiçan.

2. Anëtarët e këshillit, me shumicë votash e zgjedhin njërin nga anëtarët e këshillit për kryetar të këshillit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit drejtues

1. Mblkëqyrë punën e Teatrit të Qytetit Gjiçan
2. Aprovon politikat afatgjata zhvillimore dhe artistike të Teatrit të Qytetit Gjiçan.
3. Me propozim të drejtorit general, miraton planin e vjetor të buxhetit të Teatrit të Qytetit Gjiçan.
4. Me propozim të udhëheqësit artistik, dhe në përputhje me buxhetin vjetor, miraton programin vjetor artistik të Teatrit të Qytetit Gjiçan.
5. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar të Teatrit.
6. Harton dhe propozon statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore, të cilat i voton asambleja komuna në Gjiçan.
7. Interviston kandidatët dhe zgjedh drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik.
8. Inicion procedurën dhe merr vendim për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm dhe udhëheqësit artistik.
9. Mund të shkarkoj kryetarin e Këshillit Drejtues, në çdo kohë. Vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

10. Njierr konkluzione, akte nënligjore, vendime, rekomandime për mbarvajtjen e punës së Teatrit të Qyteit Gjilan, duke u bazuar në ligj dhe statut.

11. Në rast të lejes nga Këshilli Drejtues për angazhim të drejtorit general dhe udhëheqësit artistik jashtë punëve të Teatrit të Gjilanit, leja jepet vetëm me shkrim së bashku me kushtet e angazhimit të mundshëm.

Neni 4

Përbërja dhe mandati

1. Këshilli drejtues i Teatrit të Qyteit Gjilan përbëhet prej pesë (5) anëtarëve me të drejtë vote dhe emërohet nga kryetari i komunës së Gjilanit.
2. Anëtarët e keshillit drejtues duhet të jenë personalitete të dëshmuara në fushën e teatrit.
3. Njëri nga pesë (5) anëtarët e keshillit duhet të jetë përfaqësues i komunës së Gjilanit.
4. Mandati i anëtarit të keshillit drejtues është katër (4) vjeçar, me të drejtë emërimi edhe për një tjetër mandat.
5. Për punën e tij, Këshilli Drejtues i raporton kryetarit të komunës së Gjilanit, së paku një herë në vit.
6. Anëtarët të keshillit drejtues, nuk mund të jenë drejtori gjeneral i teatrit apo udhëheqësi artistik.

Neni 5

Kompensimi për punën e keshillit drejtues

1. Anëtarët dhe sekretari, për punën e tyre kompensohet financiarisht. Kompensimi i tyre është, si në vijim:
 - 1.1. Kryetari i keshillit paguhet në vlerë 150 euro në muaj.
 - 1.2. Anëtarët e keshillit paguhet në vlerë 120 euro në muaj.
 - 1.3. Keshilli obligohet ta mbajë së paku një mbledhje brenda muajit.

Neni 6

Mbledhjet kuorumi

1. Mbledhjet e Keshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson, kryetari i Keshillit Drejtues.
2. Në rast të mungesës së kryetarit, mbledhjen e kryeson anëtar i më i vjetër i Keshillit Drejtues.
3. Anëtarët e Keshillit Drejtues ftohet së paku dy ditë para mbledhjes. Ftesa dërgohet me shkrim përmes e-mailit apo ndonjë formë tjetër me të cilën ftesat arrijnë në adresën e të ftuarve.
4. Keshilli Drejtues ka kuorun, nëse në mbledhje marrin pjesë së paku tre (3) anëtarë.
5. Mungesa e anëtarit të Keshillit Drejtues, duhet të arsyetohet.
6. Kryetari i Keshillit është i obliguar të thërras mbledhje, nëse kërkohet nga së paku tre (3) anëtarë.
7. Kryetari i Keshillit ka të drejtë, në çfarëdo kohe, të ftoj ekspertë ose persona të tjerë me qëllim të sqarimit të gëshjive që kërkojnë vendimmarrje nga Keshilli Drejtues.
8. Keshilli Drejtues ka të drejtë të ftoj në mbledhje drejtorin general, në cilësinë e raportuesit. Drejtori është i obliguar t'i përgjigjet kërkesës së Keshillit dhe mungesa e tij

- duhet të arsyelohet.
9. Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje. Në rast mungese për shkaqe të arsyeshme, duhet ta njoftojnë me shkrim Këshillin Drejtues.

Neni 7

Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë:
- 1.1. Mbledhjet e rregullta, të cilat mbahet së paku dy herë në muaj; dhe
- 1.2. Mbledhjet e jashtëzakonshme, të cilat mbahen me kërkesën e Drejtorit të Teatrit të Gjiarit apo së paku tre anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 8

Mbledhjet, miratimi i rendit të ditës

1. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për thirrjen dhe ecurinë e mbledhjeve.
2. Kryetari e hapë, e kryeson, e ndërprejë dhe e përfundon mbledhjen.
3. Kryetari nuk mund ta përfundoj mbledhjen, nëse së paku tre anëtarë mendojnë se nuk duhet mbledhja të përfundojë.
4. Në fillim të mbledhjes, kryetari verifikon kuorumin, propozon rendin e ditës, hapë diskutimin, merr propozime për pika të tjera të rendit të ditës dhe pas diskutimit i hedhë në votim dhe konstaton miratimin ose jo të rendit të ditës.
5. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mbledhjen, pasi të jetë votuar rendi i ditës, për çfarëdo arsye, kryetari i Këshillit është i obliguar të thërras vazhdimin e mbledhjes. Nuk mund të thirret mbledhje e re, para së përfundohen qeshjet e ngritura në mbledhjen e ndërrprejë.
6. Këshilli Drejtues ka të drejtë të kërkojë raporte për qeshjet të caktuara, nga Drejtori i Teatrit apo zyrtarët e tjerë të institucionit.
7. Secilin propozim për rend dite nga çdo anëtar, kryetari i Këshillit është i obliguar ta propozoj për votim si pikë e rendit të ditës.

Neni 9

Vendosja/ Votimi

1. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të plotfuqishme, vetëm nëse së paku votojnë tre anëtarë.
2. Votimi për propozimet e Këshillit Drejtues, bëhet i hapur.
3. Votimi bëhet: "Për", "Kundër" dhe "Abstenuim".
4. Vota e anëtarëve të Këshillit konsiderohet e barabartë dhe vendimi konsiderohet i miratuar nëse merr së paku 3 vota "për".

Neni 10

Shkarkimi i drejtorit dhe udhëheqësit artistik

1. Këshilli Drejtues inicion procedurën dhe vendos për shkarkimin e Drejtorit ose Udhëheqësit Artistik, në këto raste:

- 1.1. Për shkelje të ligjit, statutit, rregulloreve dhe akteve të tjera të cilësuar si shkelje të rënda;
- 1.2. Për shkelje të vazhdueshme, e të cilat nuk cilësohet si shkelje të rënda;
- 1.3. Për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar;
- 1.4. Për shkak të kryerjes së veprës penale.

Neni 11

Procesverbali i mbledhjes së këshillit drejtues

1. Në çdo mbledhje të këshillit drejtues mbahet procesverbal.
2. Procesverbali duhet t'i përmbajë këto elemente: a) vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes; b) rendin e diës; c) emrat e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë; d) të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe e) shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes. Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks.
3. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues në mbledhjen e ardhshme të Këshillit.
4. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhme të Këshillit Drejtues
5. Materiali i procesverbalit ruhet në arkiv të drejtorisë së kulturës.

Neni 12

Zbatimi i rregullores

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe personave të tjerë të ftuar apo angazhuar në procedurat e Këshillit Drejtues.

Neni 13

Zbrazëtitrat Jurike

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, do të vendosë anëtarësia e këshillit me shumicë votash, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Teatrot, Statutit të Teatrit të Giljanit dhe praktikave më të afërta.

Neni 14

Dispozitat Kalimtare

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Këshilli Drejtues i Teatrit të Giljanit dhe mbikqyret nga Kryetari i Komunës

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të MAPL dhe shtatë ditë pas publikimit në gjetet zyrtare në web faqen e Komunës së Gjiçanit.

01.Nr.016-82515
Gjiçan, më 04.08.2023



Kryesuesi i KkG Gjiçan
M. Kadriu
M. Kadriu / Kadriu